

Pyetje dhe përgjigje gjatë takimit informues të mbajtur në kuadër të programit Green-AL

Thirrja për Grante të Rrjetëzimit, Advokimit dhe Ndikimit në Potikbërje

Pyetje dhe përgjigje mbi komponentin teknik

Pyetje

A mund të aplikojë një rrjet i cili është formuar nga organizata shqiptare dhe nga organizata të shteteve fqinje?

Përgjigje

Jo, organizatat që dëshirojnë të aplikojnë në këtë thirrje, duhet të operojnë në Shqipëri dhe të jenë të gjitha të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar, përkatësisht ligjit nr. 8788 datë 07.05.2011 "Për organizatat jofitimprurëse".

Pyetje

Nëse një grup organizatash ngrenë një problematikë mjedisore lokale, por që zgjidhja i takon një vendimarrjeje të nivelit qendror, a mund të ketë bashkëpunim me këto aktorë?

Përgjigje

Ne sugjerojmë që në rast se një grup organizatash duan të trajtojnë një një çështje të tillë, e cila lidhet ngushtësisht me një territor të caktuar, të aplikojnë për grante në rrjetet rajonale dhe ndërkohë që janë shpallur dhe fituesit e rrjeteve kombëtare, të faktorizojnë diskutimin me këto të fundit.

Pyetje

A mund të aplikojë në këtë thirrje një grup jo-formal?

Përgjigje

Jo, nuk mund të aplikoni në këtë thirrje si organizatë, por mund të përfshiheni tek partnerët bashkëpunues pa buxhet.

Pyetje

Të gjitha organizatat, qofshin këto Lider apo Bashkë-aplikantë, duhet të jenë mbi tre vite të regjistruara sipas legjislacionit shqiptar?

Përgjigje

Nëse doni të aplikoni për grante në Rrjetet Rajonale, organizata Lider duhet të ketë minimalisht 3 vite eksperiencë. Ndërkohë, nëse doni të aplikoni për grante në Rrjetet Kombëtare, organizata Lider duhet të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë. Bashkë-aplikantët, të cilët janë organizata të shoqërisë civile të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi, duhet të kenë minimalisht një vit eksperiencë.

Pyetje

Ka ndonjë kriter në lidhje me përvojën që bashkë-aplikantët duhet të kenë, qoftë në Rrjetet Rajonale apo ato Kombëtare? Çfarë dokumentash duhet të dorëzojnë bashkë-aplikantët?

Përgjigje

Aplikanti Lider ka përgjegjësi për bashkë-aplikantët; që do të thotë që dhe në varësi të tematikës që do të adresoni, duhet të ngrihet dhe rrjeti. E rëndësishme për Autoritetin Kontraktues është që rrjetet e formuara, të formohen me minimalisht 3 organizata, të cilat duhet të jenë domosdoshmërisht OSHC. Autoriteti Kontraktues do të ketë marrëdhënie vetëm me aplikantin Lider.

Pyetje

Është kusht i domosdoshëm aplikimi me 2 apo 3 bashkë-aplikantë?

Përgjigje

Po, duhet të jenë minimalisht 3 organizata që të formohet një rrjet. Organizata Lider duhet të ketë fokus mjedisin; 2 bashkë-aplikantët e tjerë jo domosdoshmërisht duhet të jenë organizata mjedisore.

Pyetje dhe përgjigje mbi komponentin financiar

Pyetje

Formati i buxhetit do të paraqitet në një dokument të vetëm për të gjithë partnerët apo duhet të jetë i ndarë?

Përgjigje

Buxheti duhet të paraqitet i plotë; që do të thotë që për Autoritetin Kontraktues nuk përbën interes cilat zëra i përkasin njërit bashkë-aplikant apo tjetrit. Nëse doni të jepni informacione të tilla, mundeni ta bëni tek kolona e komenteve në aneksin e buxhetit.

Pyetje

Ekspertët në buxhet paraqiten në pikën 4 dhe 5 të këtij formati. Cili është ndryshimi midis tyre?

Përgjigje

Nuk ka asnjë ndryshim, mund të vendoset në të dy linjat e buxhetit.

Pyetje

Kur përmenden tenderat për materialet apo produktet, vlen edhe për ekspertizat apo do të merret e mirëqenë nëse dërgohet një CV e ekspertit? Gjithashtu, ekspertiza mund të jetë me faturë shërbimi dhe jo tatim në burim.

Përgjigje

Në rastin kur ekspertiza është me faturë shërbimi, nuk ka nevojë për të mbajtur tatim në burim, sepse bëhet fjalë për një person juridik, në të cilin taksat dhe tatimet paguhen tek NIPTI i lëshuar tek fatura. Në rast se

ekspertiza do të jetë me kontratë shërbimi, pa faturë, atëherë patjetër duhet të keni përlogaritur tatimin në burim. Ndërkohë, vlera e blerjeve për shërbime dhe produkte mbi 2500 Euro, duhet të kalojnë nëpërmjet një procesi përzgjedhës.

Pyetje

Ku mund të marrim një dokument që vërtetohet që shteti ende nuk ka kthyer TVSH-në? Çfarë dokumenti duhet të paraqesim që të quhet kosto e vlefshme?

Përgjigje

Nëse TVSH-ja do të konsiderohet e lejueshme apo jo, do të vendoset në një moment fundor; do të jetë një problematikë për ata aplikantë të cilët do të jenë përfutues të granteve. Në momentin e shkrimit të propozimit, nuk është e detyrueshme për t'i vënë Autoritetit Kontraktues në dispozicion dokument që vërteton që TVSH-ja është e rimbursueshme apo jo.

Pyetje

Si do të detajohet formati i buxhetit, duke qenë që do të jenë minimalisht 3 organizata dhe buxheti do të jetë i përbashkët?

Përgjigje

Buxheti duhet të përfshijë të gjitha aktivitetet që organizatat do të propozojnë. Marrëdhënia mbi si do të ndërtohet buxheti ndërmjet partnerësh është individuale/marrëdhënie e brendshme. Nëse doni të paraqisni një buxhet ndan qartë se disa shpenzime i takojnë secilit partner, jeni të lejuar. Sërish, në rast se doni ta mbani buxhetin në mënyrë të përgjithshme, është e lejuar.

**Projekti Green-AL "Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Mbrojtjen e Mjedisit në Shqipëri" financohet nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim me fondet e Qeverisë Suedeze dhe zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit në bashkëpunim me organizatat CISP (Comitato Internazionale per Sviluppo dei Popoli), VIS Albania (Volontario Internazionale per lo Sviluppo) & COSV (Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario).*